


Inflacioni mujor, vjetor në përqindje (%) në Kosovë për periudhën Janar Qershor 2026

Ky material paraqet një përmbledhje të normave të inflacionit për periudhën janar - qershor 2026, duke u fokusuar veçanërisht në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Sipas publikimit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dt. 10 korrik 2026, IHÇK-Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë për 6,0 % në muajin qershor 2026, krahasuar me muajin qershor 2025.

Shkalla e rritjes së çmimeve të konsumit në Qershor 2026 ishte 6,0 % vjetore.


Figura 1. Normat mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit në qershor 2026, është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: transporti (13,7 %), strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (11,1 %), pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (5,1%), restorante dhe shërbime akomodimi (4,5%), shëndetësia (4,1%), ushqime dhe pije joalkoolike (3,9 %), kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (3,2 %), mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake (3,0 %), veshje dhe këpucë (2,3 %), rekreacion, sport dhe kulturë (2,0 %) dhe informacion dhe komunikim (0,2 %). Ndërkohë, rënie e çmimeve është regjistruar në grupin shërbimet arsimore (-0,6 %).

Figura 2. Normat mesatare vjetor të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

(*) normat mesatare vjetor për vitin 2026 bazohet në trendin janar- qershor 2026,

Nga grafiku shihet se gjatë **periudhës janar - qershor 2026**, kemi një trend rritës të Indeksit të çmimeve të konsumit (IHCK) **me një mesatare vjetore prej 6.5%** (nga 5.8 % në janar, 6.0% në shkurt, 6.7% në mars, deri në 7.5% në prill, 6.8% në maj dhe 6.0%, në qershor) krahasuar me muajt përkatës të vitit 2025.

Nga të dhënat e disponueshme për Kosovën, inflacioni gjatë gjysmës së parë të vitit 2026 u udhëhoq kryesisht nga rritja e dukshme e çmimeve të ushqimeve bazë dhe mënyrës së jetesës (transport dhe energji), duke bërë që vendi të shënojë normat më të larta në rajon. Ky trend preku pikun në prill me 7.5%, si pasojë e shtrenjtimit të karburanteve dhe kostove të banesave, përpara se të zbuste ritmin në 6.0% në qershor falë stabilizimit të përkohshëm të tregjeve të importit. Trendet rritës të çmimeve u shkaktua kryesisht nga këta faktorë me peshë të madhe si:

- 01-Ushqime dhe pije joalkoolike, me norma të rritjes nga 8.0%(shkurt); 6.5%(mars), 5.6%(prill), 5.1%(maj) dhe 3.9% (në qershor). Rajoni i Ballkanit ndikohet fortë nga importet dhe luhatshmëria e çmimeve bujqësore, Kosova është shumë e ndikuar me inflacion të lartë të grupi i ushqimeve, që ka peshë të madhe në shportën e konsumit,
- 04-Strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse, me norma të rritjes nga 15.7%(shkurt); 15,2%(mars), 15,2%(prill), 13,2%(maj) dhe 11,1%(në qershor), rritja e çmimeve të lëndëve djegëse dhe energjisë ishte faktori më dominues gjatë kësaj periudhe, duke shtrenjtuar drejtpërdrejt kostot e operimit, dhe
- 07-Transporti, me norma të rritjes nga 10,5%(mars), 16,1%(prill), 14,1%(maj) dhe 13,7% (në qershor). Rritja e kostove të transportit dhe kufizimet tregtare, (si tensionet në zinxhirët agro-ushqimorë) rrisin çmimet. inflacioni në vendet e vogla të hapura si Kosova është shumë më i ndjeshëm ndaj importeve dhe me deficitit të lartë tregtar.

Tabela 1. Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në %, për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it, ¹

COICOP Grupe dhe nëngrupet	Peshat 2026 në ‰	VI - 2026 2015=100	VI - 2026 V- 2026	VI- 2026 VI- 2025
00. IHÇK total	1,000.00	106.1	-0.1	6.0
01. Ushqime dhe pije joalkoolike	327.6	104.1	-0.6	3.9
02. Pije alkoolike, duhan	57.6	105.1	0.2	5.1
03. Veshje dhe këpucë	42.6	102.5	0.1	2.3
04. Strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse	94.1	110.3	-0.3	11.1
05. Mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake	77.7	103.5	0.2	3.0
06. Shëndeti	29.6	104.5	0.1	4.1
07. Transporti	188.5	113.1	0.3	13.7
08. Informacion dhe komunikim	39.6	100.1	0.0	0.2
09. Rekreacion, sport dhe kulturë	29.5	102.7	0.8	2.0
10. Shërbimet arsimore	8.3	99.6	0.5	-0.6
11. Restorante dhe shërbime akomodimi	43.1	105.3	0.2	4.5
12. Sigurime dhe shërbime financiare	19.2	100.0	0.0	0.0
13. Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme	42.6	103.6	0.4	3.2

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela në vazhdim përmban të dhëna mbi çmimin mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime të konsumit, gjendjen 2023-2025 dhe një vlerësim i përafërt për 06/2026*, bazuar nga të dhënat Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në %, për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it.

Tabela 2. Çmimet mesatare në euro(€) për disa artikuj dhe shërbime më reprezentuese 2023-2025 dhe vlerësim 06/2026*

Kodi	Artikujt	Njësia	2023	2024	2025	vlerësim 06/2026*
101	Oriz	1 kg	1.67	1.67	1.73	1.80
102	Miell gruri	1 kg	0.82	0.80	0.83	0.86
103	Bukë e bardhë	500 gr	0.51	0.52	0.54	0.56
111	Mish gjedhi pa eshtra	1 kg	8.95	8.95	10.47	10.88
112	Mish viçi	1 kg	10.00	10.13	11.39	11.83
114	Mish pule	1 kg	4.09	4.07	4.47	4.64
131	Qumësht (tetrapak)	1 lit	1.22	1.20	1.24	1.29
133	Jogurt	1 lit	1.16	1.20	1.24	1.29
137	Vezë	30 copë	3.43	2.83	3.65	3.79
141	Vaj ushqimor luledielli	1 lit	1.72	1.42	1.64	1.70
153	Banane	1 kg	1.53	1.44	1.51	1.57

¹ COICOP paraqet, Classification of Individual Consumption According to Purpose, (Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit),

161	Patate	1 kg	0.77	0.72	0.70	0.73
162	Domate	1 kg	1.39	1.49	1.43	1.49
163	Fasule	1 kg	3.26	3.36	3.77	3.92
167	Speca të padjegës	1 kg	1.91	2.06	2.07	2.15
175	Sheqer	1 kg	1.20	1.26	1.19	1.24
192	Kafe e bluar	1 kg	11.56	12.61	15.30	15.90
193	Çaj (Cejlon)	1 kg	9.30	9.29	9.51	9.88
195	Uji mineral	1.5 lit	0.36	0.39	0.42	0.44
196	Coca cola	2 lit	1.43	1.53	1.59	1.65
213	Cigare Lucky strike	1 pako	2.29	2.35	2.46	2.59
215	Cigare Ronson	1 pako	1.99	2.06	2.15	2.26
416	Energjia elektrike (pa kosto fikse)	1 kwh	0.07	0.07	0.08	0.09
418	Dru të zjarrit	1 m ³	58.24	60.24	58.12	64.60
701	Benzin	1 lit	1.36	1.31	1.25	1.42
702	Dizel	1 lit	1.38	1.30	1.23	1.40

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Nëse analizojmë faktorët që kanë pasuar ndikim në trendin e inflacionit në nivelin regional, nga të dhënat e disponueshme për vendet e Ballkanit Perëndimor, mund të vërehet një rritje e inflacionit të këto vendet gjatë periudhës janar - qershor 2026, veçanërisht në Kosovë, Bosnjë dhe Maqedoninë e Veriut. Kjo e ndikuar kryesisht nga ndërveprimi i faktorëve si “rritja e kostos” dhe “kërkesa” në raport të drejtpërdrejtë në disa nga komponentët e COICOP-it.

Në Europë (Eurozonë), inflacioni në periudhën janar - qershor 2026 u rrit kryesisht në një **mesatare prej 2.6%**, duke arritur pikun e përkohshëm në 3.0% në muajin prill, përpara se të zbriste përsëri në 2.8% në muajin qershor për shkak të shtrenjtimit drastik të kostove të energjisë (e cila shënoi rritje vjetore deri në 10.9% në prill), i nxitur nga zhvillimet gjeopolitike, konflikti në Lindjen e mesme dhe kufizimet e furnizimit në tregjet e naftës dhe gazit.

Më poshtë paraqitet tabela me normat mesatare të inflacionit për 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6) për vitin 2025 dhe janar-qershor 2026*.

Tabela 3. Normat të inflacionit (ndryshimi në % krahasuar me të njëjten periudhë/muaj të vitit paraprak),


Shteti (WB6)	2025 (mesatare vjetore)	Jan-Qer 2026* (mesatare vjetore)	Janar 2026	Shkurt 2026	Mars 2026	Prill 2026	Maj 2026	Qer 2026
Kosovë	3.9%	6.5%	5.8%	6.0%	6.7%	7.5%	6.8%	6.0%
Bosnjë e Herceg.	4.0%	4.9%	3.6%	3.3%	5.1%	6.8%	5.6%	n/a*
Maqedoni V.	4.1%	4.1%	3.2%	3.4%	4.9%	4.7%	4.8%	3.4%
Mal i Zi	3.9%	3.3%	2.9%	2.6%	3.1%	3.8%	3.6%	3.6%
Serbi	3.8%	2.9%	2.4%	2.5%	2.8%	3.3%	3.5%	2.7%
Shqipëri	2.2%	2.8%	2.3%	2.5%	2.8%	2.8%	3.0%	3.2%

*Shënim: Të dhënat për mesataren vjetore 2025 dhe janar- qershor të vitit 2026 bazohen në trendet e raportuara nga tradeconomics dhe të dhënat e fundit të publikuara nga institucionet e vendeve përkatëse.

Vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6), në periudhën janar - qershor 2026 shfaqën një trajektore heterogjene, ku Kosova regjistroi **inflacionin më të lartë në mesatare rreth 6.5%**, ndërsa Shqipëria Serbia dhe Mali i Zi, **shënuan nivelet më të ulta të stabilizuara në rreth normave 2.8% deri 3.3%**.

Në përgjithësi gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2026, ushqimet dhe pijet alkoolike mbetën shtytësi kryesor i inflacionit në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke pasur peshën më të madhe në rritjen e indeksit të çmimeve të konsumit. Në të njëjtën kohë, sektori i transportit pësoi luhatjet më të forta, ku pas një rritjeje të ndjeshme në pranverë për shkak të shtrenjtimit të karburanteve, shfaqti një tendencë stabilizimi drejt qershorit. Ndikim dytësor, por të qëndrueshëm patën edhe kostot e banesave (energji, ujë, qira) si dhe sektori i hoteleri-turizmit, veçanërisht në Shqipëri dhe Mal të Zi me afrimin e sezonit veror. Në vijim figura normat mesatare vjetore e inflacionit për 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Figura 3. Normat vjetore e inflacionit për 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6), mesatarja për vitin 2025 dhe janar - qershor 2026*



Burimi: Të dhëna nga tradingeconomics dhe të dhënat e fundit të publikuara nga institucionet e vendeve përkatëse